

**Faik Hoti**

Kryeredaktor

Në këtë numër të Revistës “Mjeku”, fokusi ynë kryesor është një nga shtyllat themelore të sistemit shëndetësor: emergjencat dhe urgjencat mjekësore. Këto situata, të paparashikueshme dhe shpesh kritike, kërkojnë reagim të menjëhershëm, vendimmarrje të saktë dhe profesionalizëm të lartë, me qëllim që të bëjnë dallimin ndërmjet jetës dhe vdekjes.

Ky botim që trajton emergjencat spitalore dhe paraspitalore, duke përfshirë menaxhimin e traumave të ndryshme, situatat akute që rrezikojnë shëndetin e fëmijëve dhe problemet kritike që prekin të rriturit, ndërlihet dhe shërben edhe si mbështetje për Kongresin e VII-të të Mjekësisë “Emergjenca, Kujdesi Intensiv dhe Anestezioni: Sfidat e së ardhmes”, organizuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës. Qëllimi është që përmes artikujve të zgjedhur nga fushat e ndryshme mjekësore, të fuqizohen njohuritë e profesionistëve të shëndetësisë dhe të ofrohet një qasje e qartë, e strukturuar, e mbështetur në prova shkencore dhe në praktikën e ballafaqimit me këto sfida.

Në mjekësi, gjatë trajtimit të emergjencave dhe urgjencave mjekësore, çdo sekondë ka peshë. Prandaj, rëndësia e njohjes së udhërrëfyesve dhe protokolleve të reagimit të shpejtë, triazhimit të drejtë, vlerësimit korrekt klinik, koordinimit ndërmjet ekipeve të emergjencës dhe përdorimit efikas të burimeve, mbetet esencial në praktikë përditshme. Trajnimi i vazhdueshëm, përditësimi i njohurive dhe përgatitja profesionale janë elemente kryesore të suksesit për të garantuar ndërhyrje korrekte dhe shpëtim jete.

Përmes përmbajtjes multidisciplinare, revista kontribuon në forcimin e kapaciteteve tona profesionale për të përballur çdo situatë emergjente me kompetencë dhe siguri, sidomos për profesionistët që punojnë në vijën e parë të kujdesit shëndetësor. Shprehim falënderimin dhe mirënjohjen e sinqertë për të gjithë autorët, bashkëpunëtorët dhe profesionistëve që kontribuan në përgatitjen e këtij numri. Dedikimi dhe angazhimi i tyre, e bëjnë këtë botim një vlerë të rëndësishme dhe të përbashkët për komunitetin mjekësor në vend.

